



Plani i Zhvillimit Strategjik | 2020-2025

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Përmbajtja

Vizioni, misioni dhe vlerat e një Universiteti të projektuar drejt së ardhmes

I.	Vizioni	fq. 3
II.	Misioni	fq. 3
III.	Vlerat dhe Parimet	fq. 4

Prioritetet dhe objektivat: zhvillimi i vazhdueshëm i tyre

IV.	Programet e studimit: nevojat e individit, të shoqërisë dhe të tregut të punës	fq. 5
V.	Kërkimi shkencor	fq. 6
VI.	Ndërkombëtarizimi	fq. 8
VII.	Organizimi dhe menaxhimi institucional: promovimi i një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë	fq. 9

Studenti dhe shërbimet

VIII.	Zhvillimi i karrierrës dhe lidhja me tregun e punës	fq. 12
IX.	Biblioteka Universitare	fq. 12
X.	Shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT)	fq. 13

Universiteti “Aleksandër Moisiu” një dritare e hapur drejt së ardhmes

(Arritje dhe objektiva)

XI.	Analiza e pozicionimit (SWOT)	fq. 15
XII.	Përgjegjësia sociale dhe civile	fq. 18
XIII.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” një dritare e hapur drejt së ardhmes (Arritje dhe objektiva)	fq. 19

Vizioni, misioni dhe vlerat e një Universiteti të projektuar drejt së ardhmes

I. Vizioni

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë.

Integrimi i tij në proceset social-ekonomike, garanton një shtytje të rëndësishme të komponentëve të ndryshëm të shoqërisë, në mirëqënien dhe ndërgjegjësimin e saj. Kufijtë e rinj të zhvillimit ekonomik bazohen gjithnjë e më shumë në dije, prandaj Universiteti, synon të jetë faktor vendimtar në “ekonominë e dijes”, nëpërmjet formimit të profesionistëve të rinj, të gatshëm të përballen me sfidat e tregut të punës dhe në të njëjtën kohë të shfrytëzojnë mundësitë që bota dhe tregjet ndërkombëtare ofrojnë.

Vizioni që propozohet është ai i një Universiteti të lirë dhe autonom, pararojënë mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor, i aftëtë udhëheqë studentët në mënyrë të përgjegjshme duke kontribuar dënjësisht në tregun e punës, i aftë të influencojë botën akademike dhe të përballojë sfidat e bashkësisë shkencore ndërkombëtare.

Plani Strategjik synon një identitet të forte dhe të qartë, nëpërmjet forcimit të gjitha këtyre pikave, duke e bërë Universitetin “Aleksandër Moisiu”, kompetent, konkurrues në vend dhe të projektuar drejt hapësirës ndërkombëtare të Arsimit të Lartë.

II. Misioni

Misioni i Universiteti “Aleksandër Moisiu”, është të rris prestigjin dhe të sjell shkencë dhe punësim, nëpërmjet ofrimit të programeve të studimit në të tre ciklet e studimit, të studjuarit gjatë gjithë jetës, aftësimin të personelit akademik, duke e bërë UAMD-në një qendër nevralgjike të zhvillimit të dijes, inovacionit dhe ekonomisë.

UAMD, propozohet si një subjekt i hapur për botën, i projektur drejt së ardhmes, drejt ndërkombëtarizimit, pikërisht marrëdhëniet ndërkombëtare janë një aspekt qendror i misionit dhe veprimtarisë së tij.

UAMD, ka simision të kryej mandatin e tij arsimor dhe shkencor në mënyrë të kënaqshme dhe në hap me kohën, të promovojë Arsimin e Lartë duke shkëmbyer njohuri dhe duke gjeneruar ide të reja dhe moderne, të promovojë dhe mbështesë projekte inovative kërkimore që inkurajojnë dhe forcojnë lidhjen midis tregut të punës dhe Universitetit, të garantojë mundësi të barabarta për stafin akademik në përfitimet e financimeve për kërkim shkencor.

Formimi, zhvillimi dhe trasmetimi i dijeve mbetet objektiv kryesor, me qëllim aftësimin e studentëve tanë për transformimin e tyre personal, suksesin profesional dhe përmirësimin e të mirave të përbashkëta, nëpërmjet një mjedisi dinamik, pro angazhimit në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe gjithëpërfshirje në kërkimin shkencor, nëpërmjet ofrimit të hapësirave për më shumë komunikim, diskutim të lirë dhe të gjallë, në respekt të ndërsjellë për formimin me bindje individuale, si akselerues i angazhimit social-komunitar.

III. Vlerat dhe Parimet

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, frymëzohet nga një sër vlerash dhe parimesh të cilat do të vazhdojnë të drejtojnë aktivitetet e tij në të ardhmen si, liria akademike, autonomia institucionale, integriteti, cilësia dhe ekselencia në mësimdhënie dhe etika në kërkimin shkencor.

Gjithashtu burime të rëndësishme që konsolidojnë vlerat e UAMD-së, janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe Statuti i UAMD-së, në bazë të të cilave Universiteti aspirojnë përmbushjen e misionit të tij në frymën e respektimit të dinjitetit të njeriut, të parimit të barazisë dhe pluralizimit të ideve.

Prioritetet dhe objektivat: zhvillimi i vazhdueshëm i tyre

IV. Programet e studimit: nevojat e individit, të shoqërisë dhe të tregut të punës

Investimi në cilësinë e mësimdhënies, pa diskutim, është një përparësi e Universitetit, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu objektiv i rëndësishëm është edhe favorizimi i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog.

Në vitet 2020-2025, UAMD do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Modeli aktual do të plotësohet dhe kombinohet me metodologji më të kompletuara si: *peer to peer*, *focus group*, sondazhe të shpeshta, etj.

UAMD karakterizohet nga diversiteti dhe larmia e programeve të studimit që ofrohen në disiplina të ndryshme, të tilla si:

- Ekonomi/ shkenca ekonomike (biznes/sipërmarrje, financë-kontabilitet, turizëm, menaxhim, marketing);
- Shkenca sociale e humane (Edukim/Pedagogji, Sociologji/Probleme Sociale, Psikologji/Shërbim psikologjik, Gjuhësi, Letërsi);
- Shkenca politike e juridike (Drejtësi, Administrimi Publik/Administratë, Shkenca Politike, Shkenca komunikimi);
- Teknologji dhe Informacion (Shkencave Kompjuterike, Teknologji Informacioni);
- Shkenca Mjekësore (Mjeksi/ShëndetPublik);
- Shkenca të natyrës dhe inxhinierike (Shkenca Inxhinierike, Mekanikë, Transport).

Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, pasi përcaktimi i fushave prioritare të studimit janë të identifikuar në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar.

Për sa i përket interesit rajonal, UAMD synon trajnimin e specialistëve në sektorët e turizmit, detarisë, menaxhimit dhe shërbimeve financiare.

Përdorimi me efektivitet i marrëveshjeve ekzistuese mbi praktikat e studentëve dhe arritja e marrëveshjeve të reja që synojnë krijimin e lidhjeve reale me tregun e punës me qëllim punësimin e mundshëm të tyre si edhe krijimi i një mekanizmi ndërlidhës efektiv e të drejtpërdrejtë të Zyrës së Karrierës dhe Alumni me departamentet e ndryshme të universitetit. Në fokus do të jenë edhe studimet e tregut për përmirësimin e programeve të studimit apo kurrikulave. Gjithashtu edhe ofrimi i lëndëve në gjuhën angleze, gjë e cila do të ndikonte pozitivisht në mobilitetin në hyrje dhe në dalje të studentëve në UAMD.

Synim do të jetë edhe atraktiviteti i diplomave të ciklit të parë të studimeve nëpërmjet kurrikulave të tyre të pasuruara dhe të përshtatura me tregun e punës.

Objektiv i vizionit strategjik janë edhe zhvillimi i masterave dhe specializimeve, masterat profesional janë lidhja direkte me tregun e punës, prandaj një fokus të veçantë do të ketë oferta formuese e tyre. Gjithashtu, programet e studimit të ciklit të parë do të harmonizohen me programet e studimit të ciklit të dytë.

Angazhimi për aplikime në projekte me objekt kryesor përmirësimin e kurrikulave, siç janë projektet (me skadencë muajin shkurt të çdo viti) në Erasmus +. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe shqyrtimi i mundësive për krijimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta studimi me universitete të huaja, sidomos të programeve që zhvillohen në gjuhën angleze. UAMD është në proces të vazhdueshëm ndërkombëtarizimi, në mbështetje të strategjisë së tij për kohezionin ndërinstitucional dhe konkurrencën globale.

V. Kërkimi shkencor

Në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, kërkimi shkencor mbetet një nga prioritetet strategjike kryesore, fokusuar në nxitjen dhe promovimin e ekselencës akademike. Kjo reflektohet në shumëllojshmërinë e fushave të studimit specifike dhe ndërdisiplinore, në rritjen e produktit shkencor të stafit akademik si edhe nëpërmjet promovimit e diskutimit të rezultateve kërkimore nëpërmjet organizimit të konferencave, workshop-eve, tryezave të rrumbullakëta, simpoziumeve, etj.

Kërkimi shkencor përveç karakterit inovator duhet të ofrojë edhe zgjidhje praktike për politikbërje, për zhvillimin e komunitetit dhe për vendimmarrje në organizatat e biznesit dhe në

ato jo-fitimprurëse. UAMD e vlerëson arsimin e lartë si përgjegjësi publike dhe e konsideron universitetin si një institucion që mbështetet në dy gjymtyrë të së njëjtës peshë e rëndësi: mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, prandaj objektiv dhe sfida e rëndësishme do të jetë shndërrimi i Universitetit “Aleksander Moisiu”, në një universitet të bazuar në kërkimin shkencor (Research-based University).

Synim është edhe nxitja dhe suporti në zhvillim të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve, pasi integrimi real i mësimdhënies me kërkimin shkencor është një domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shkollimit universitar, në kushtet kur shkolla (duke përfshirë universitetet), e ka humbur monopolin e të qenit informuesi i vetëm dhe kur studentët kanë akses informativ aq sa edhe vetë pedagogët e tyre. Sfida e sotme nuk lidhet me informimin e studentit të painformuar, por me formimin e studentit të informuar. Kjo kushtëzon: (a) leksione që dalin edhe nga kërkimi i drejtpërdrejtë; (b) përfshirjen e studentit në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuara prej tij; (c) shndërrimin shkallë-shkallë të raportit “pedagog-student” në “udhëheqës-kërkues”, sidomos në nivelin master e doktoraturë.

Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencorë shtë një moment i rëndësishëm, e konsideruar si mundësi “e artë” për të realizuar objektivat e kërkimit shkencor, si kërkesë për formimin e tyre profesional dhe qytetar, si rrugë për të rritur shkallën e përvetësimit të programeve mësimore, si një mënyrë për pasurimin e CV-në e tyre që në kohën e studimeve universitare dhe orientimin e tyre në tregun e punës.

Objektiv strategjik është edhe përmbushja e kriterëve për promovimin e personelit akademik dhe dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore.

Vazhdimi i programeve të doktoraturës të riorganizuara sipas kërkesave ligjore në Fakultetin e Biznesit, gjatë vitit akademik 2021-2022 e në vijim, si dhe hapjen e programeve të reja të doktoraturës në dy fakultet të tjera: Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike, nga viti akademik 2021-2022. Objektiv është edhe hapja e programeve të ciklit të tretë në Fakultetin e Studimeve Profesionale dhe në Fakultetin e Teknologjisë së Infomacionit. Me qëllim që çdo departament/njësi bazë të jetë qendër graviteti e veprimtarisë kërkimore-shkencore.

Shqyrtimi i mundësive për themelimin e “UAMD Publishing House” (UAMD Press) si shtëpi botuese e librit universitar, si dhe i “Librarisë Universitare UAMD”, kjo për botimin e librave universitarë dhe për menaxhimin e shitjeve, duke synuar njëherësh plotësimin e standardeve akademike të mësimdhënies dhe gjenerimin e të ardhurave për kërkimin shkencor.

Botimi i të paktën dy revistave shkencore (periodikë) të UAMD, të veçanta apo në partneritet me institucione që kanë revista shkencore të çertifikuara si të tilla, me status akademik të pranueshëm për kualifikimin shkencor të personelit akademik dhe marrjen e titujve shkencorë.

Angazhimi, në mënyrë të veçantë, për përfshirjen e UAMD, njësive të tij kryesore dhe bazë si dhe çdo pedagogu të disponueshëm, në projekte dhe programe të ndryshme, përmes të cilave krijohen përvoja akademike dhe gjenerohen të ardhura, të tilla si:

- Programe të shkëmbimeve afatshkurtra për pedagogët dhe studentët, me mbështetjen financiare të programit Erasmus +, të sponsorizuar nga Komisioni Evropian;
- Programe në bashkëpunim me Universitete të rajonit dhe Evropës për të siguruar mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve.

Angazhimi për të siguruar lidhjet ndërkombëtare, sidomos me Universitetet Evropiane për të aplikuar në projekte të përbashkëta për ngritje kapacitetesh në Erasmus + (programi ish Tempus), për të siguruar më shumë mundësi trajnimit për stafin akademik dhe administrativ, për mbështetje në pajisje dhe laboratorë sipas prioritetit të nevojave që do të përcaktohen.

Aplikimi për programet e Kërkimit Shkencor dhe të ciklit të tretë të studimeve pranë Marie për zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik për kërkimin shkencor, si dhe në pasurimin e bibliotekës së UAMD me literaturën e nevojshme për pasurimin e syllabuseve.

VI. Ndërkombëtarizimi

Procesi i ndërkombëtarizimit të njohurive përfaqëson një nga shtyllat kryesore të sistemit arsimor rajonal, evropian dhe global. Për të mbështetur këtë proces, UAMD ka hartuar “*Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021*”, kjo e fundit synon që Universiteti të jetë një aktor i rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të qytetit dhe rajonit duke i ofruar studentëve dije dhe njohuri akademike cilësore në përputhje me standartet ndërkombëtare për arsimin e lartë.

Ndër linjat e veprimit për arritjen e këtij qëllimi është rritja e partneriteteve midis insitucionave të huaja të Arsimit të Lartë, duke i bërë marrëveshjet aktuale të shkëmbimit të studenteve dhe të stafit akademik më domethënëse në formë të tilla që të ofrohen diploma të përbashkëta apo të dyfishta me universitetet partnere në kuadrin e disa programeve të caktuara studimesh me interes të përbashkët, si pasojë brezat e rinj të studentëve do të jenë në gjendje të bashkëpunojnë në një mjedis multikulturor.

UAMD, synon edhe rritjen e vizibilitetit në arenën ndërkombëtare të arsimit të lartë, nëpërmjet zhvillimit dhe forcimit të strukturave primare dhe atyre mbështetëse, për ndërkombëtarizimin e institucionit. Gjithashtu, objektivi strategjik është edhe zhvillimi, bashkëpunimin dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik, ndërkombëtar nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe. UAMD është e vendosur të arrijë gjatë periudhës së planit strategjik, rritjen e numrit dhe cilësisë në zbatimin të projekteve zhvillimore, në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë, inovacionit dhe transferimit të teknologjive duke e projektuar Universitetin edhe më shumë drejt një dimensionit të ri kombëtar dhe ndërkombëtar.

Objektiv është edhe rritja e numrit të profesorëve dhe studiuesve të huaj nga universitetet prestigjioze të panoramës ndërkombëtare, por edhe rekrutimi i studentëve të huaj.

Gjithashtu, në vëmendjen e Institucionit do të jetë edhe ndërkombëtarizimi i doktoraturave, kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet forcimit të dimensionit ndërkombëtar, të bashkëpunimit efektiv në nivel shkencor me Universitetet e huaja, pasi kërkimi shkencor po bëhet gjithmonë e më shumë i hapur dhe i ndarë me të gjithë.

Të gjitha këto aspekte janë një shenjë e qartë e rrugës që është ndërmarrë dhe do të konsolidohet.

VII. Organizimi dhe menaxhimi institucional: Promovimi i një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë

UAMD, ka nisur rrugëtimin e tij drejt zhvillimit, konsolidimit dhe maturimit institucional, në përputhje me përparësitë e Strategjisë së tij, linja të përqendruara tek përmirësimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

UAMD, ka ndër aktorët kryesorë studentin dhe shoqërinë dhe në të gjithë veprimtaritë e tij synon në mënyrë të vazhdueshme të arrijë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare. Trasferimi i dijeve nënkupton që Institucioni duhet të jetë në hap me kohën për t'iu përgjigjur kërkesës aktuale të tregut të punës, për këtë arsye UAMD synon vazhdimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me organizma nga sektori publik dhe ai privat.

Universiteti është i përkushtuar për të siguruar cilësi dhe kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet procedurave efektive menaxhimi dhe organizimi të strukturave, të cilat sigurojnë mbarëvajtjen e proceseve akademike dhe kërkimore si edhe të veprimtarisë menaxheriale të Universitetit.

Një zë i lirë dhe i rëndësishëm është edhe ai i organeve kolegjiale të zgjedhura, të cilat funksionojnë sipas Statutit dhe mundësojnë diskutimet, debatet dhe marrjen e vendimeve në formë gjithëpërfshirëse, përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik dhe në organe të tjera kolegjiale të zgjedhura garantohet në çdo rast dhe pjesëmarrja është dinjitoze dhe frytdhënëse.

Në këndvështrimin financiar, UAMD, gëzon një stabilitet të provuar ndër vite. Bordi i Administrimit është organ kolegjial në të cilin marrin pjesë përfaqësues të Institucionit dhe të financuesve kryesor të Institucionit (Aktualisht qeveria e Republikës së Shqipërisë, MASR). Ai ndjek procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik dhe jo akademik në përputhje me LAL dhe akteve të tjera nënligjore, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit.

Synim strategjik është efikasiteti i organizimit, nëpërmjet promovimit të një kulture të vëmëndjes ndaj cilësisë në menaxhimin e të gjitha aktiviteteve institucionale, nëpërmjet një qasjeje që koncepton punën, mësimdhënien, kërkimin shkencor jo vetëm në aspektin sasior por edhe në atë cilësor, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë organizative por edhe inkurajimin dhe evidentimin e ekselencave, pasi mund të luajnë një rol të rëndësishëm në drejtimin e Institucionit, duke i dhënë kështu një përfitim të gjithë sistemit, sepse Plani Strategjik, mund të implementohet vetëm nëpërmjet mbështetjes së kapitalit njerëzor dhe të profesionalizimit të atyre.

Parimi i cilësisë do të udhëheqë aktivitetin organizativ të Universitetit, realizimi i këtij objektivi mund të arrihet nëpërmjet rregullave të qarta meritokratike për përparimin e karrierës dhe

monitorimit, vetëvlerësimit të vazhdueshëm dhe transparent në të gjitha nivelet, sepse kritika dhe vet korrigjimi mund të sjellë cilësinë, e cila në këtë rast përkthehet si cilësi e mësimdhënies, kërkimit shkencor, stafit administrativ, akademik, shërbimeve, etj.

Objektivi rëndësishëm është edhe akreditimi periodik i Institucionit dhe i programeve të studimit, me qëllim përmirësimin, konsolidimin dhe forcimin e cilësisë që qëndron në themel të shërbimeve të ofruara nga UAMD.

Gjithashtu, Kampusi Universitar është një hapësirë e përbashkët që duhet menaxhuar në mënyrë efikase për një zhvillim sa më të mirë të jetës universitare.

Rrugëtimi drejt cilësisë do të shënohet nga trasparenca, kosto racionale në menaxhim, pjesëmarrje dhe vendimarrje gjithëpërfshirëse ku studenti dhe stafi mund të japin opinionet e tyre mbi rishikimin e procedurave dhe cilësinë e shërbimeve, pa diskutim edhe nga efikasiteti dhe fleksibiliteti në stafin administrativ, të cilët gjithmonë e më shumë do të jenë kompetentë.

Studenti dhe shërbimet

VIII. Zhvillimi i karrierës dhe lidhja me tregun e punës

Në ditët tona krahas mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, zhvillimi i karrierës është një shtyllë e rëndësishme e universiteteve. Tranzicioni i suksesshëm i studentëve nga jeta universitare në rrugëtimet e tyre të pas-diplomimit bazuar në një kuptim të qartë të procesit të zhvillimit të karrierës, kredenciale konkurruese dhe zotërimin e strategjive bashkëkohore për identifikimin e mundësive të karrierës që reflektojnë interesat, aftësitë dhe aspiratat e tyre, është një objektivi strategjik i Universitetit “Aleksandër Moisiu”.

Objektiv është edhe angazhimi i Institucionit për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre akademike dhe udhëve të karrierës që do të ndjekin. Rol të rëndësishëm luan Qendra e Karrierës e cila synon gjithmonë e më shumë të ofroj një shërbim cilësor nëpërmjet këshillimeve, orientimeve dhe seminareve për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës.

Gjithashtu, moment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i marrëdhënieve me studentë, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktikat studentore, punësimin dhe mundësitë e karrierës. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me departamentet e Universitetit, Qendra asiston studentët në zhvillimin dhe artikulimin e përvojave bashkëkurrikulare që do t'i ndihmojnë ata të jenë konkurrues në përpjekjet e tyre për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.

Theksi do të vihet në orientimin e karrierës dhe fuqizimin e të rinjve për të zhvilluar mundësitë e tyre për punësim.

VII. Biblioteka Universitare

Biblioteka Universitare është e angazhuar për të siguruar shërbime cilësore për stafin, studentët dhe komunitetin përmes një mjedisi të sigurtë, mikpritës dhe që ofron shumëllojshmëri të hapësirave që frymëzojnë të mësuarin, hulumtimin dhe nxisin kreativitetin, gjithashtu burimet e informacionit janë lehtësisht të arritshme, të besueshme, dhe të një cilësie të lartë.

Për të arritur këtë biblioteka lipset të nxisë njohuritë dhe përdorimin e koleksioneve dhe shërbimeve, të nxisë angazhimin e gjithë anëtarëve të komunitetit, të sigurojë hapësira kreative por mbi të gjitha të përqafojë kulturën e inovacionit dhe dixhitalizimit.

Moment i rëndësishëm është agazhimi i bibliotekës në planifikimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm për përmbushjen e misionit në mënyrë efikase dhe efektive, në mënyrë që të çojë përpara vlerat profesionale të lirisë intelektuale, vlerat dhe të drejtat e pronësisë intelektuale, ruajtjen e privatësisë së përdoruesit dhe aftësimi i përdoruesve në informacion, të mbështesë zhvillimin dhe aftësimin në informacion, për suksesin akademik, kërkimin shkencor dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës. Gjithashtu, biblioteka duhet të zbulojë informacion në të gjitha formatet për përdoruesit, duke përdorur mjetet dhe teknologjinë e fundit, të sigurojë akses në koleksione të mjaftueshëm në cilësi, thellësi, format, diversitet, për mbështetjen e hulumtimit dhe mësimdhënies.

Synim është ofrimi sa më cilësor i burimeve dhe shërbimeve fizike dhe dixhitale, sigurimi i hapësirave të gjera dhe fleksibël të mësimit, për të frymëzuar të mësuarit si edhe të punuarit me stafin akademik për mbështetjen e bibliotekës.

UAMD, aspiron standardet më cilësore në shërbim të zhvillimit të hapësirave të bibliotekës, të sigurimit efikas të shërbimeve, zhvillimin dhe zgjerimin e shërbimeve ekzistuese, zhvillimin e kanaleve elektronike me përdoruesit si edhe maksimizimin e burimeve elektronike por edhe minimizimin e pengesave në hulumtimin e materialeve.

Përveç hapësirave të mësimit, të vazhdojë të ofrojë hapësira sociale që plotësojnë kërkesat e përdoruesve tanë, të mbështesë kërkuesit me anë të workshop-ve, udhëzuesve individualë si edhe të zhvillojë shërbimet për një akses të hapur.

VIII. Shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT)

Mjedisi i përparuar teknologjik i Universitetit ka rëndësi strategjike pasi teknologjia e informacionit dhe komunikimit është themelore për kërkimin shkencor, praktikën mësimore dhe veprimtaritë e tjera të komunitetit universitar.

Në këtë fushë, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, ka identifikuar tre qëllime kryesore për këtë cikël të ri të planifikimit të shërbimeve të ICT-së:

1. Të ndihmojë komunitetin e UAMD-së që të përdorë në mënyrë efektive internetin;
2. Të ofrojë shërbime dhe sisteme të sigurta;
3. Të përkrahë invacionin në kërkim dhe mësimdhënie.

Duhet marrë parasysh se shumë faktorë mjedisor ndikojnë në objektivat strategjike të cilët janë: përshpejtimi i vazhdueshëm në ritmin e ndryshimit në teknologjinë e informacionit; kompleksiteti në rritje i shërbimeve teknologjike dhe integrimi i tyre; nevojat për shërbime të një komuniteti universitar të shpërnadarënë të gjithë vendin; ndryshimet në mënyrën sesi fakulteti dhe studentët përdorin teknologjinë dhe njohuritë; elementët e sigurisë që janë gjithnjë në ndryshim dhe në rritje.

*Universiteti “Aleksandër Moisiu” një dritare e hapur drejt së ardhmes
(Arritje dhe objektiva)*

IX. Analiza e pozicionimit (SWOT)



Pikat e forta

- *Cilësia e stafit akademik-* formimi dhe eksperiencia akademike brenda dhe jashtë vendit, mosha relativisht e re, niveli i kualifikimit në rritje, vërtetuar me gradat e titujt e fituar, garantojnë transmetimin efektiv të dijeve. Studentët vlerësojnë vazhdimisht cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet pyetësorëve semestralë.
- *Cilësia e studentëve-* garantohet nëpërmjet kritereve të pranimit dhe cilësia në dalje dëshkohet nëpërmjet vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse të studimit si edhe punësimit të studentëve.
- *Oferta akademike e larmishme-* e zgjeruar nga ana sasiore, në të tria nivelet e studimit është një bazë e mirë për zhvillimin e një oferte akademike më konkurruese dhe të përshtatshme me tregun.
- *Komunikimi efektiv student-pedagog-* i reflektuar në komunikimin organizativ të përditshëm pedagog-studentë ka ndikuar në ndërtimin e një kulture organizative që lehtëson jo vetëm proceset akademike por edhe ato administrative.
- *Transparenca në kontrollin e dijeve-* bazuar në kontrollin e njohurive teorike dhe praktike, organizimi i provimeve të ndërmjetme e përfundimtare, ballafaqimi i vlerësimit në çdo rast, përdorimi i sistemeve të informatizuara (Pitagora) për publikimin e vlerësimeve dhe kontrollin e tyre të automatizuar (Cleanscore).
- *Mobiliteti në rritje i stafit akademik-* stafi akademik shkëmben vazhdimisht eksperiencia në mësimdhënie e në kërkim shkencor në universitete ndërkombëtare.
- *Akreditimi institucional i universitetit dhe akreditimi i programeve të studimit-* Universiteti “Aleksandër Moisiu”, disponon akreditimin insitucional dhe akredimin e programeve të studimit në nivelin e Masterit Profesional duke vijuar në vazhdimësi me akredimin e programeve në nivelet e tjera të studimit duke siguruar përmirësimin e menaxhimit të vazhdueshëm të cilësisë.
- *Rritja e anganzimit social dhe kulturor-* rritje e aktiviteteve dhe iniciativave sociale dhe kulturore të studentëve.
- *Ndërkombëtarizimi i universitetit me projekte të larmishme evropiane-* nëpërmjet pjesëmarrjes në shkëmbime universitare me programet Erasmus+, Horizont 2020.
- *Mobiliteti i studentëve-* pjesmarrja në programin Erasmus+ ka mundësuar shkëmbimin ndërkombëtar të studentëve.

Pikat e dobëta

- *Cilësia e kërkimit shkencor*- rritja e botimeve me faktor impakti mbetet një sfidë së bashku me mbështetjen dhe financimin kërkimit shkencor nga projektet ndërkombëtare.
- *Konsolidimi i rrjetit alumni dhe i ndjekjes së zhvillimit profesional të studenteve*- shoqërohet me një mungesë të monitorimit dhe ndjekjes profesionale së studentëve si edhe me mangësitë e treguesve në dalje.
- *Mungesa e mbështetjes së teknologjisë së informacionit për mësimdhënie*- e reflektuar në mungesën e pajisjeve hardware që lehtësojnë mësimin në auditor si edhe mbështjetja *software* për mësimdhënien në distancë dhe kërkimin shkencor shoqëruar me rritjen e kapaciteteve të stafit dhe studentëve. Në mjediset fizike të universitetit nuk është e mundur lidhja me *wireless*.
- *Mungesa e vlerësimit 360 gradë dhe menaxhimi i vazhdueshëm i cilësisë së mësimdhënies*- mungesa e elementëve të vlerësimit 360 gradë për stafin e akademik e cila do të mundësonte përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.
- *Mbështetje financiare e stafit akademik për kërkimin shkencor*- mungesa e financimit për projektet kërkimore shkencore.
- *Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit administrativ*- mungesa e trajnimit dhe azhurnimit të stafit administrativ është një mangësi pasi metodat e punës evoluojnë dhe formimi i kapitalit njerëzor luan një rol të rëndësishëm në mënyrë që burimet ekzistuese të përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme.

Mundësitë

- *Rritja e efektivitetit të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar në studime dhe kërkim shkencor*- pasurimi i eksperiencës ndërkombëtare nëpërmjet pjesëmarrjes në shkëmbime universitare me programet Erasmus+, Horizont 2020, etj.
- *Përfitimimi nga grantet kërkimore ku mund të angazhohen dhe studentët*- përfshirja e studentëve, sidomos atyre të programeve master në studime që mund të realizohen në kuadrin e fitimit të granteve kombëtare dhe ndërkombëtare.

- *Transformimi i universitetit në një aktor të zhvillimit rajonal dhe komunitar-* qyteti i Durrësit, me vendndodhjen e tij gjeografike dhe rëndësinë ekonomike në vend, ofron një sërë mundësish për zhvillimin e modelit Triple Helix, Universitet-Industri-Qeveri. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, mund të kthehet në aktor edhe për zhvillimin social dhe ekonomik të komunitetit rajonal.
- *Bashkëpunimi me bizneset dhe grupet e tjera të interesit-* këto mundësi mund të reflektohen në mundësitë e punësimit të studentëve, realizimit të praktikave mësimore, konsulencave apo mbledhjen e të dhënave për kërkimet shkencore.
- *Hapja e programeve të reja të studimit përfshirë edhe ato të doktoraturës, si dhe programet e përbashkëta (joint-degrees)-* bazuar në nevojat e tregut, të matura me studime të mirëfillta.

Kërcënimet

- *Konkurrenca ndërmjet IAL-ve publike dhe private-* programet e ngjashme të studimit të ofruara nga IAL publike apo private brenda vendit mund të jenë një alternativë për studentët e niveleve të ndryshme të studimit.
- *Ulja e numrit të përgjithshëm të popullsisë shkakton edhe uljen e numrit të studentëve-* ndaj rritja e cilësisë në të gjithë aspektet është e vetmja zgjidhje për përballimin e së ardhmes plot sfida.
- *Mundësitë e kufizuara të financimit publik-* financimi publik i kufizuar, kërkon gjetjen e mundësive alternative të financimit.
- *Mungesa e faciliteteve-* zona ku ndodhet kampusi i ri i universitetit mund të jetë problematikë për zhvendosjen e studentëve për shkak të mungesës së një sistemi transporti modern edhe efikas.

X. Përgjegjësia sociale dhe civile

Si një institucion modern, në përputhje me objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, angazhohet në çështjet më të

rëndësishme të botës globale, sikurse është ndryshimi klimatik në nivel rajonal e kombëtar, promovimi i barazisë, paqes dhe tolerancës. Universiteti promovon drejtësinë sociale duke garantuar mundësitë e barabarta për të gjithë studentët dhe stafin si dhe angazhohet në çdo iniciativë për përmirësimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektiva kryesorë janë, minimizimi i dëmit mbi mjedisin, maksimizimi i fitimit nga pikëpamja sociale.

Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirjes në programin e lëndëve specifike të problematikave të zhvillimit të qëndrueshëm, të kërkimit shkencor në këtë fushë si edhe të aplikimit në projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, ndërgjegjësimi për ndikimin mjedisor në ambientet e universitetit dhe krijimi i një kulture të ekonomisë së gjelbër. Nxitja e vullnetarizmit studentor nëpërmjet aktiviteteve që kanë ndikim pozitiv në zhvillimin komunitar.

Objektiv strategjik janë edhe aplikimi i parimeve të barazisë, të gjithëpërfshirjes dhe diversitetit si edhe trajtimi i studentëve me bursa financiare duke pasur parasysh studentët nga grupet vulnerabël. Këto parime mund të respektohen nëpërmjet mbrojtjes dhe promovimit të diversitetit, nxitjes së politikave dhe procedurave në mbështetje të studentëve vulnerabël e në nevojë si edhe përmes promovimit të vlerave demokratike tek studentët për ngritjen e insitucioneve të forta dhe nxitjen e kulturës së pjesëmarrjes në vendimmarrjet brenda dhe jashtë UAMD-së.

XI. Universiteti “Aleksandër Moisiu” një dritare e hapur drejt së ardhmes (Arritje dhe objektiva)

Viti akademik 2006-2007 shënon vitin e parë të Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, me 1000 studentë nga e gjithë Shqipëria.

Filozofia e UAMD-së ka qenë dhe është “*Studenti në qendër të vëmendjes*”. Kjo nënkupton një përkushtim të vazhdueshëm të stafit duke u dhënë studentëve çdo lehtësi në përditshmërinë e procesit didaktik dhe më gjerë. Kështu, UAMD është i pari institucion në vend që ka aplikuar

që në ditën e tij të parë, teknologjinë e *total student management system*, për t'u mundësuar studentëve zgjedhjen e orarit, njohjen me vlerësimet e kreditet në një sistem të dixhitalizuar me akses individual.

Për më tepër, UAMD është i pari institucion i arsimit të lartë në Shqipëri që solli modelin e *Community College* huazuar nga SHBA-ja, ky model karakterizohet nga organizimi i studimeve në dy vite akademike, me 120 kredite ECTS, në profile kryesisht profesionale.

Nga ana tjetër, UAMD është i vetmi institucion në vend që krijoi një fakultet sipas modelit të akademisë profesionale (*berufsakademie*) të sistemit gjerman, të Baden-Wurtemberg. Sipas këtij modeli, studentët përveçse ndjekin procesin mësimor në auditore janë edhe të punësuar në kompani.

Nëpërmjet procedurave transparente me kritere dhe standarde ndërkombëtare akademike, UAMD ka përthithur një staf akademik cilësor, duke u dhënë përparësi kandidatave ekselente nga sistemi shqiptar dhe perëndimor i arsimit të lartë. Që në krye të herës, UAMD arriti të përfshijë një staf akademik me moshë mesatare të re, ku afro 30% janë të diplomuar në BE dhe SHBA. Statistikat tregojnë që stafi akademik i UAMD-së ka përfituar më shumë se çdo institucion tjetër nga programet *brain gain* të iniciuara nga pushteti ekzekutiv në fushën e arsimit të lartë.

Njësitë kryesore kanë pasur një dinamikë zhvillimi të konsiderueshme duke zgjeruar programet e studimit në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë.

Në vitin 2016, i'u nënshtrua procesit të akreditimit institucional dhe me vendim Nr. 10 dt. 7.4.2017 të ASCAL dhe British Accreditation Agency, u rendit si institucion i akredituar, me vlerësimin "Shkëlqyer", për pesë vite akademike.

Një kampus i ri universitar, ndërtuar në vitin 2017, i krijon mundësi UAMD-së të rrisë kapacitetet mësimdhënëse më një logjistikë. Sot, UAMD, është i vetmi institucion i Arsimit të Lartë që ka në pronësi një kapacitet infrastrukturor e premtues për zhvillimin e tij të mëtejshëm.

Të shumta janë edhe arritjet dhe objektivat e realizuara në Planin e Zhvillimit Strategjik 2016-2020, të tilla si:

- Garantimi i përgatitjes cilësore dhe suksesit të studentëve;

- Ekselencë në mësimdhënie dhe në kërkimin shkencor;
- Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus nxitjen e partneriteteve;
- Përgatitja e programeve të integruara dhe bashkëkohore;
- Përfshirja e aspekteve praktike me studimet lëndore përgjatë të gjithë kurrikulës, duke mundësuar nxënien e një dije të transferueshme dhe të aplikueshme në tregun e punës;
- Menaxhimi i burimeve për promovimin e kërkimit shkencor;
- Zhvillimi i fushave të reja kërkimore;
- Mbështetja shumëdimensionale dhe multifaktoriale e personelit akademik;
- Mbështetje në ekselencën e mësimdhënies dhe promovimin e eksperiencave pozitive;
- Rritja dhe konsolidimi i bashkëpunimit ndërinstitucional me komunitetin e biznesit, me qëllim përfitimin e ndërsjelltë;
- Krijimi dhe zhvillimi i një strukture bashkëkohore të komunikimit, me qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve me grupet e interesit;
- Ruajtja e profesionalizmit dhe zhvillimi i stafit në përputhje me vlerat e UAMD-së;
- Zhvillimi dhe integrimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, me qëllim interaktivitetin në mësimdhënie dhe mësimnxënie me objektiv zhvillimin e mundësive të reja, të cilat garantojnë akses në dije;
- Ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies;
- Optimizimi dhe shfrytëzimi i hapësirave funksionale, me qëllim rritjen e efikasitetit strukturor;
- Ofrimi i shërbimeve për të tretë (Institucione dhe biznese), nëpërmjet veprimtarive kërkimore shkencore, ideimit, krijimit dhe zhvillim, me qëllim gjenerimin e të ardhurave;
- Kombinimi i elementëve cilësor të mësimdhënies me aktivitete *off-kampus*, me qëllim krijimin e një mjedisi të larmishëm akademiko-rekreativ;
- Kontakti i vazhdueshëm dhe real me komunitetin, me qëllim promovimin, informimin dhe angazhimin në formacione të ndryshme të komunitetit;
- Ofrimi i zgjidhjeve të integruara ndaj problematikave rajonale dhe kombëtare të fushave studimore nëpërmjet veprimtarive njohëse, promovuese, krijuese e kërkimore me objektiv promovimin e vlerave qytetare dhe komunitare;

- Promovimi dhe mbështetja e ndërkombëtarizimit të studimeve nëpërmjet ofrimit të programeve në gjuhë të huaj dhe optimizimit të impaktit që mobiliteti ofron;
- Krijimi, rritja dhe ruajtja e një baze të dhënash të kompetencave të stafit akademik;
- Ofrimit të dijës në mënyrë të aksesueshme dhe pa kosto.

Sukseset e arritura deri më tani, së bashku me studentët, do të jenë kapitali më i rëndësishëm në të cilin do të mbështetet zhvillimi i institucionit në pesë vitet e ardhshme.

Në pesëvjeçarin vijues (2020-2025), UAMD do të ketë një ofertë akademike konkurruese të përshtatur me tendencat globale. Kjo nuk do të thotë vetëm rritje sasiore e ofertës akademike, por edhe përshtatja e tyre sipas kërkesave të tregut të punës. Bazuar në studime serioze, çdo departament duhet të transformojë dhe shtojë programet e studimit, duke i bërë ato më fleksibël dhe të përshtatshme në periudha kohore të caktuara.

Ndërkombëtarizimi i studimeve do të jetë në fokus në vitet e ardhshme. Kurrikula e programeve në pesë vitet vijuese do të pasurohet me lëndë në gjuhën angleze. Kështu, çdo departament, do të ketë një grup kursesh, kryesisht në vitet e dyta e të treta, me mësimdhënie në gjuhën angleze. Kjo do të ndihmojë studentët në përmirësimin e aftësive të tyre në gjuhë të huaj dhe në përgatitjen për mobilitet në universitetet evropiane. Nga ana tjetër, këto kurse do të përbëjnë bazën për përthithjen e studentëve të huaj, të ftuar në kuadrin e programeve të shkëmbimit Erasmus +.

Ndërkombëtarizimi do të zhvillohet njëkohësisht me modernizimin e infrastrukturës. Në pesë vitet e ardhshme, auditoret e UAMD-së do të modernizohen me pajisje teknologjike si video projektorë, PC e lidhje të shpejta interneti për të bërë të mundur një mësimdhënie bashkëkohore dhe interaktive. Modernizimi i auditoreve do të shoqërohet edhe me modernizimin e bibliotekave, ambjenteve shplohëse, etj.

Në kuadrin e tregut të punës, në vitet 2020-2025, bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare, ndërkombëtare, institucionet shtetërore dhe biznesin do të intensifikohen dhe standartizohen. Drejtorja e Alumnit, krahas këshillimit të karrierës do të shërbejë edhe si një zyrë ndërlidhëse punësimi mes studentëve diplomantë dhe punëdhënësve. Studentët do të asistohen nga Drejtorja e Alumnit në lidhje direkte me departamentet, kjo drejtori do të nxisë zhvillimin e praktikave, programeve internship, intervistave të punës, punësimeve të ndryshme sezonale, etj.

Nga ana tjetër do të gjurmojë në vazhdimësi të diplomuarit tanë të cilët do të jenë ambasadorët e UAMD-së kudo që ata do të punojnë e jetojnë.

Në vitet 2020-2025, UAMD do të ketë një model të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies. Modeli aktual do të plotësohet dhe kombinohet me metodologji më të kompletuara si: *peer to peer*, *focus group*, sondazhe të shpeshta, etj.

Kërkimi shkencor, në vitet 2020-2025 do të jetë i orientuar drejt rritjes cilësore, nëpërmjet shtimit të aplikimeve në projekte ndërkombëtare kryesisht evropiane. Botimet në revistat ndërkombëtare të indeksuara do të jenë objektiva për çdo anëtar të stafit akademik. Gjithashtu kërkimi shkencor do të zhvillohet edhe nëpërmjet angazhimit të departamenteve në projekte të ndryshme kërkimore shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

E njëjta frymë do të mbahet në konsideratë në hapjen e shkollave të doktoraturës nëpër departamentet e FB, FE, FSHPJ, sipas projekteve kërkimore në fushat prioritare për vendin dhe rajonin. Për këtë, është e nevojshme një rritje progresive e stafit me tituj akademikë. Ndaj, në pesëvjeçarin e ardhshëm, UAMD do të vendosë të gjithë kapacitetin e vet financiar, infrastrukturor, administrativ për të motivuar stafin akademik për publikime cilësore jashtë vendit, përfshirje në projekte ndërkombëtare kërkimore, përfshirje në borde editoriale të revistave kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

UAMD do të ketë një angazhim më domethënës në thithjen e maturantëve më të mirë brenda vendit. Kjo do të realizohet nëpërmjet një plani marketingu-diseminimi, pjesë e këtij plani marketingu do të jenë edhe vetë studentët e UAMD-së, të cilët do të përcjellin mesazhe motivuese bazuar në eksperiencat e tyre.

Gjithashtu, studentët e vitit të parë do të orientohen dhe këshillohen në mënyrë më efektive mbi jetën universitare. Çdo departament do të ketë një plan aktivitetesh dhe do të jetë një urë komunikimi konkrete me studentët e rinj. Për këtë universiteti do të gjej burimet financiare për vendosjen e bursave dhe stimujve të tjerë për studentët më të mirë.